




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipality of Assembly

01-Nr. 464-1651/2017
Kaçanik, 24.01.2017

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 2.4.3.6 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së palujtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-205 të nenit 58 Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës" nr.28/15 Qershor 2008), nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, kërkesës për Shpronësim të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, më datë 24.01.2017, merr:

V E N D I M

I. MIRATOHET kërkesa për iniciimin e procedurës për shqyrtim të metejshëm e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit për shpronësim të pronës së palujtshme dhe atë: parcela kadastrale **nr.00580-0, me culture ndërtesë, me sipërfaqe prej 105 m²**, Zona Kadastrale Kaçanik, në emër të NEWCO SHARR TREGTIA KAÇANIK COMPLEX A.L.L.C Qirambajtje 99 vite e cila ndërlidhet me projektin për ndërtimin e Parkut të Qytetit në Kaçanik.

2. Vlera e kompenzimit të pasurisë së palujtshme të theksuara më lartë do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përfitojnë pronarët dhe zotëruesit e interesit, të cilët preken nga procesi i shpronësimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financa. Komisioni I vlerësimit do të kompenzohet nga ana e Komunës së Kaçanikut.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesohet: kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet: Kryetari,
DUKMM
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa,
Arkivi i Komunës dhe Web.faqën e Komunës.

